

PROCESVERBAL III/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 3 (tretë) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	30.03.2021
Ora:	10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani
 Z. Bashkim Ndrecaj
 Z. Brahim Curri
 Z. Alban Berisha
 Z. Shefket Kolgeci
 Z. Xhemajl Kabashaj
 Znj. Elmaze Bytyqi
 Znj. Bulëza Kuçi
 Znj. Shqipe Ramaj
 Z. Lirim Qatani
 Z. Reshat Selimaj
 Z. Ardian Kotorri
 Z. Bexhet Kuçi
 Z. Aziz Bytyqi
 Z. Gazmend Gashi
 Znj. Bardha Gashi
 Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi
 Z. Jeton Rrakaqi
 Z. Arbërim Basha
 Z. Dardan Berisha
 Znj. Marigona Gashi
 Znj. Florie Bytyçi
 Z. Sami Hajdari
 Znj. Shkëndije Zenelaj
 Z. Osman Selimaj
 Z. Leonard Shala
 Z. Dugagjin Palushi
 Znj. Laureta Tafaj
 Z. Gëzim Kryeziu
 Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
 Media dhe qytetarë
 OSCE, LMT, KDI
 Habibe Bytyqi
 Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe e prezantoi rendin e ditës:

REND DITE

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit (1) të pronës së paluajtshme të Komunës;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për ti zhvilluar procedurat e konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërtimin e QKMF-së;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri - alokimin e mjeteve branda fondit burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2021 nga projektet kapitale;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Dhjetor 2020**
7. **Diskutim lidhur me menaxhimin e investimeve kapitale;**
8. **Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit,dhe i njofton me rendin e ditës.Kemi dhe tre pika shtesë.

E para është betimi i anëtarës së re në Asamble,znj.Shkëndije Zenelaj, e dyta ka të bëj me futjen në KPF të anëtares së re e cila është zëvendësu me Albana Bytyqin,të cilës i takon me automatizëm,dhe e treata ka qenë pikë shtesë në KPF,e cila ka kalu për Asamble dhe ka të bëj me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së pluajtshme të Komunës(për vendosjen e trafostacioneve).

Bashkim Ndrecaj - kërkoj që të futet në rend dite pika e cila ka të bëj me diskutimin e byfesë e cila gjendet në oborrin e gjimnazit “Jeta e Re”,për faktin se kur e keni pru projekt-vendimin e keni arsyetu me disa argument,se është e nvojshme bifeja jasht dhe keni premtu masa për funksionimin e kësaj byfeje.

Kryesuesi – ne patëm tre kërkesa nga ata persona dhe ju kemi përgjigj në mënyrë ligjore.

Jeton Rrakaqi - edhe unë jam përgatit me diskuu për këtë pike,propozoj të diskutohet te pyetje dhe përgjigje.

Nexhat Ramadani – ju i keni dhënë përgjigje,mirëpo është kërkesë e një asambleisti dhe jeni të obligun me qit në votim.

Dardan Berisha – përshëndet të pranishmit.kjo pike është dasht me shku në drejtori të arsimit,sepse nuk është kompetencë e jona por e menaxherit të shkollës.

Jeton Rrakaqi – në KPF zyrtari ligjor Avniu ka dhënë sqarime shumë të qarta.

Kryesuesi – atëherë kemi katër pika shtesë dhe i hedhim një nga një në votim.

Shefket Kolgeci – përshëndet të pranishmit.Propozon që të futen të katërtat në votim,dhe pastaj të diskutohen.

Dugagjin Palushi – është i të njëjtit mendim.

Kryesuesi – e fusim në votim pikën e parë shtesë: Betimin e znj.Shkëndije Zenelaj,dhe njëherit futjen që të jetë antare në KPF.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi – e fus në votim piken e dytë: Projekt-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafostacioneve për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Jeton Rrakaqi – në KPF zyrtari ligjor na ka thënë që është shkelje ligjore.

Avni Bytyqi – përshëndet të pranishmit.Si zyrtar ligjor sqaron: mbas takimit në KPF,ne e kemi tërhek këtë pike me qëllim që të konsultohemi me Ministrinë e linjës përshkak se ligji për dhënie në shfrytëzim si dhe këmbimin e pronës së paluajtshme e përcakton qartë dhënien e pronës publike për raste të veqanta, dhe pas takimit me KEDS-in kemi vendos që këto prona të jepen në shfrytëzim me kompenzim, për arsye se ligji nuk e lejon të jepen pa kompenzim. Pas kësaj jemi konsultuar me përfaqësuesit e Ministris pushtetit lokal si dhe përfaqësuesin e departamentit të energjetikës në kuadër të ministrisë së ambientit në Prishtinë dhe kemi ardh në përfundim që të vazhdojmë me procedurën siq e kemi vazhdu më herët mirëpo në këtë projekt-vendim të përcaktohet qështja e kompenzimit.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e katër shtesë: Diskutim për byfen në oborrin e gjimnazit”Jeta e Re”.

13 për, 14 Kundër Nuk Aprovohet

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me tri pikat shtesë.

Miratohet Unanimisht

Kryesuesi dhe asambleistja e re znj.Shkëndije Zenelaj lexojnë deklaratën e betimit.

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit (1) të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe e hap debatin.

Avni Bytyqi - jep sqarime më të hollësishme si zyrtar ligjor për këtë pikë.

Gëzim Kryeziu - faleminderit për sqarime.Kompetencat është mire që janë shpërnda nëpër drejtori,por nuk e kam të qartë që kryetari duhet mi shkëput ato kontrata që nuk menaxhohen mire.

Leonard Shala - përshëndet të pranishmit.Në parim jam kundër,e kam thënë dhe në KPF.Me këtë propozim për projekt-rregullore po i bie që me përjashtu vetveten.Drejtoria e pronës,dhënia e pronës në shfrytëzim është e pakuptimtë me zhvendos edhe te tri drejtori tjera.Nuk e mbështes.

Nexhat Ramadani – përshëndet të pranishmit.I uron kolegës asambleiste suksese.Pas sqarimeve të Avniut në KPF,unë e kam vërtetu,lexu dhe kam kuptu çdo gjë që është e paraparë.Pas analizës dhe konsultimeve me grupin parlamentar ne kemi shqetësime,që në një formë Asamblea është kompetencë për dhënien në shfrytëzim të pronës.Me marrjen e një vendimi të gjitha kompetencat i barten qerverisë,dhe kërkesat e tilla Kuvendi nuk mund ti shohë por vetëm ti kontrolloj pastaj.Edhe ne si grup parlamentar nuk e votojmë.Të shtyhet më tutje.

Bashkim Ndrecaj – përshëndet të pranishmit dhe uron kolegen.Sa i përket kësaj pike jam kundër,për shumë arsye.Jemi në prag të zgjedhjeve dhe ju kisha lut me lan vitin e ardhshëm.

Avni Bytyqi – kjo projekt-rregullore nëse miratohet ju garantoj që nuk ja u merr kompetencat juve si anëtar të Kuvendit për dhënie në shfrytëzim të pronave.Lexon ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës publike.

Jeton Rrakaqi – përshëndet të pranishmit dhe i uron suksese kolegës asambleiste.Unë nuk mund ti kuptoj kolegët.Pushteti kalum ka bo rregullore për interesa personale.Shumë në rregull me bo letër,por sa do të zbatohet në praktikë.

Elmaze Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Te kjo rregullore kisha propozu që te kushtet për marrjen në shfrytëzim të pasurisë komunale të përkohshëm,të largohet projekti ideor, dhe në vend të tij të zëvendësohet me një plan biznesi,planprogram i veprimtarisë dhe rritjes së aktivitetit.

Nexhat Ramadani - brenda kësaj rregullore të gjendet forma e procesit të votimit,të jetë edhe Asamblea e implikume.Ka mundësi që me gjet forma që në procesin e votimit me shku edhe Asamblea,e kishte rrit edhe besimin.

Dugagjin Palushi – Avniu tha nuk e cenon integritetin tone,atëherë pse ka ardh këtu?

Avni Bytyqi - jep përgjigje..

Nexhat Ramadani – ideja është që Kuvendi me pas përfaqësues atje,me qenë në rrjedha të çdo kërkesë e pastaj ta raportoj Kuvendin.

Dugagjin Palushi – mangësi në këtë rregullore është çmimi.Duhet me qenë ni çmim i caktum në rregullore.

Avni Bytyqi – çmimi është i caktum sipas rregullores për tarifa dhe ngarkesa.

Florie Bytyqi – përshëndet të pranishmit.Jemi pro rregullores dhe qëllimi jonë është për zbatimin e rregullores.Mirëpo jemi kundër parafolësve që thonë : s’kemi pas anëtar të Kuvendit për formimin e komisionit.

Nexhat Ramadani – kërkesa jonë është të gjendet forma,mendojmë me elaboru më shumë.

Kryesuesi – e hedh në votim

14 për, 12 kundër , 1 apstenim Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për ti zhvilluar procedurat e konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike;

Kryesuesi - e leaboron këtë pike dhe hap deabtin.

Xhemail Kabashi – përshëndet të pranishmit.Uron kolegen.Në parim jemi për pëlqimin,mirëpo a ka kërkesa për këto prona?

Kryetari - përshëndet të pranishmit dhe i uron asambleistes së re suksese.Ne si qeverisje e kem obligim me qit në Asamble.Seancën e radhës kemi mi pas 12 prona që i kemi shkëput kontratat,ku prej vitit 2016 nuk është bë asgjë dhe s’kan pagu qira.

Xhemajl Kabashi - jam personalisht i interesuar edhe si grup parlamentar ,sepse gjatë mandatit tuaj 3 vjeçar asnjë prone e agrozonës nuk ka ardh për me dhan pëlqim.Nuk është bë asnjë përpjekje për funksionalizimin e asaj zone.

Kryetari - tjerat janë të zëna.Kryetari nuk ka të drejtë me shkëput kontratën.Vjen në Asamblen komunale ,kalon dhe jepen në shfrytëzim.

Gëzim Kryeziu - kryetari tha,a ka interesim a jo,ne do ti japim parcelat.A ka parcela tjera në Samadraxhë dhe pse s'po ipen?Këto prona a janë në një parcelë,a janë afër njëra me tjetrën?

Kryetari - ka parcela të ndryshme,nuk ka tjera.Vetëm 3 kompani kanë fillu me investime.

Xhemajl Kabashi - Kryetari thotë janë të lira vetëm këto prona,kjo sipërfaqe ka katër prona 6 ari e diçka.Agrozona ka një sip. reth 30 ha.Pse komisioni nuk ka dal në terren,dhe mi pa ata që nuk investojnë dhe me ja ndërpre kontratat,pastaj mi shpall kontratat dhe me funksionalizu atë zone.

Emrush Bytyqi - pjesa e parcelës ku kërkohet pëlqimi janë 4 parcela në Samadraxhë.Blloku i parcelave përbëhet prej 11 parcelave,mirëpo pëqimin e kanë vetë 7 parcela,dhe këto tri parcela e pengojnë dhënien e pronave pa u marrë pëlqimi i këtyre.

Xhemajl Kabashi – sa parcela janë në shfrytëzim dhe sa i kemi të lira?

Emrush Bytyqi – jep përgjigje.

Jeton Rrakaqi – Koordinohi mirë me Kryetarin sepse ai tha ska të lira,e ju thoni janë tri.

Alban Berisha – për parcelat që janë në votim.Vendimi është me metër katror,dhe i japim me meter katror, kurse mi dhan me hektar ose ari,nuk kuptova!

Avni Bytyqi – si zyrtar ligjor jep sqarime.

Alban Berisha – sa është në tërësi agrozona,dhe a duhet me marrë ni vendim?

Avni Bytyqi – 28 hektar është agrozona dhe e kemi marrë një vendim paraprak në 2015.

Kryesuesi – e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërtimin e QKMF-së;

Kryesuesi – elaboron këtë pike.

Shefket Kolgeci – përshëndet të pranishmit dhe i uron suksese asambleistes.Në emër të grupit parlamentar përshkruan një biografi për të ndjerin z.Rexhep Kuçi.Rexhep Kuçi u lind në vitin 1957 në Therand,shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Therandë.Studimet i vioji në Univerzitetin e Prishtinës,fakultetin e mjeksisë,por për shkak të rrethanave të atëhershme u detyrua ti ndërpres.Pas formimit të LDK-së ishte ndër nismëtarët e pare të krijimit së degës në Therandë.Ai me një grup mjekësh e mgriti qendrën mjeksore “Nëna Terezë”e cila funksionoi deri në vitin 1999.Ai ishte nënkryetar në Komunën e Suharekës dhe Kryesues i Asamblesë.Ai ngriti dhe avancoi një prej intitucioneve për trajtimin e njerëzve me nevoja të veqanta “Hendikos”.Pra Rexhep Kuçi tërë jetën ia kushtoi punës,familjes,shoqërisë dhe të gjithë njerëzve që kishin nevojë.

Bulëza Kuçi – falemnderon të gjithë, falemnderon edhe Kryetarin për propozimin.Unë nuk do të marrë pjesë në votim, për shkak të konfliktit të interesit.

Kryesuesi – e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri - alokimin e mjeteve branda fondit burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2021 nga projektet kapitale;

Kryesuesi – prezanton pikën dhe fton Fadil Hoxhën për një elaborim më të gjerë.

Fadil Hoxha – jep sqarime lidhur me këtë pikë si zyrëtar kryesor financiar.

Xhemajl Kabashi – sipas tyre ne kemi bo një keqklasifikim dhe janë kthyer. Nëse ne sot e votojmë, a do ta aprovojë ministria gjegjëse dhe a do të jetë valide dhe të fuqizohet.

Fadil Hoxha – jep përgjigje.

Xhemajl Kabashi – kjo qeveri lokale ka vështirësi në planifikimin buxhetor, në shpenzimin e të hyrave vetanake, pat vështirësi me 80.000 euro që i ri-alokum, pra kjo qeveri s'po mund ti shpenzoj 1.400.000 euro. Kjo qeveri ka bo fushat kundër qeverisë së kalume, se qeveria nuk po mund ti shpenzoj mjetet dhe po i kthen në subvencione.

Kryetari – Ky problem është në të gjitha Komunat. Ju po flisni gabim për arsye se subvencione nuk kemi mujt me bo ma shumë. Jemi taku me drejtorin e buxhetit dhe na ka këshillu kështu. Vitin e kalum kanë tepër vetëm 70.000 euro. Ai përmend arsyet se pse ka tepër kjo shumë e mjeteve.

Fadil Hoxha – nuk mundet me naj marrë askush këto mjete, veq kemi me ja dhanë një formë tjetër. Nëse jeni për me votu mire, nëse jo, ato mbesin si rezerva dhe nuk mundemi mi shpenzu sepse s'kanë destinim të caktum.

Nexhat Ramadani – pas konsultimeve me Fadilin, u sqaruam dhe e kuptova që mjetet që janë miratu në buxhetin tonë, ata përshkak të emërimit e kanë qit si rezerva. A keni provu me shku me tabelën që e kemi pas në KPF dhe s'ja kanë pranë dhe e keni bo tjetër.

Fadil Hoxha - jep përgjigje.

Nexhat Ramadani - te bujqësia, a nuk keni pas ide për një projekt kapital i cili kish kalu, jo me shku krejt në subvencione. Ju duhet me cek që ka projekte të reja nga ajo që është miratu. Përmend projektin “Rregullimi i brigades 123, qendra Suharekë” i cili është zëvendësuar me “punimi i rrugës “Ismail Qemali” në Suharekë”, ndërsa këto tjerat keni ndryshu diçka por me gjasë ka me kalu atje. Përndryshe unë e kam të qartë dhe ne nuk duhet me qenë pengesë e miratimit të vendimit por vetëm që Asambleistët ta kenë sa ma të qartë që kemi një lloj ndryshimi te projektet dhe a ka naj propozim tjetër.

Kryetari - Përveq rrugës në Suharekë, nuk ka ndryshime shumë të mëdhaja. Lifti është kërkesë e disa Asambleistëve.

Nexhat Ramadani – në projektin e dytë ne nuk e kemi projektin e liftit. A ka kalu kjo, si do të rregullohet?

Fadil Hoxha – ai mbetet në mallra dhe shërbime.

Nexhat Ramadani – cila është siguria që këto mjete që kanë shku atje, edhe pse të përgjysmune kanë me u zbatu po ato preprojekte.

Fadil Hoxha - jep sqarime rreth projektit qendra Suharekë i cili është ndryshu me rr. Ismail Qemali, dhe për projektin e liftit.

Bashkim Ndrecaj – Kryetar a e ke ditë atëherë pyetjen kur ja ke bërë Sali Asllanit, a shpenzohen a jo mjetet në tetor dhe nëntor? E ke dit po veq ke bo propagandë si ne sot.

Kryetari – jep përgjigje.

Nexhat Ramadani - kam thënë që duhet me bo planifikim sa ma të mire, me qëllim që kjo mbetje e vogël me shku suficit.

Dugagjin Palushi - ky ri-alokim shumë i padrejtë për fshatin Budakovë. Gjene një mundësi sepse ne kemi nevojë për ujë dhe kanalizim.

Ardian Kotorri – përshëndet të pranishmit dhe uron asambleistët e re. Pasi që u diskutua edhe mbledhjen e kalume edhe tash nga Xhemajliu, unë mbledhjen e ardhshme do ta përgadis një raport, do ta bëj nivelin e përgjithshëm të investimeve kapitale, sa kanë qenë atë mandat dhe sa janë këtë mandat.

Xhemajl Kabashi - unë nuk thash diçka të pa qenë.

Leonard Shala - Vërejtje për të dyja palët që kanë ndërruar pushtetin. Më shumë se ne ju duhet me dit që suficit ka me pas për çdo vit për shkak të procedurave. Kisha dasht me pas diskutim që a ka pas keqklasifikim të projekteve, a jo.

Kryetari - auditorët janë tu e bë auditimin për vitin e kalum dhe vjen raporti dhe shihet a ka pas keqklasifikime.

Kryesuesi - e hedh në votim.

15 për, 3 kundër, 7 apstenime Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Dhjetor 2020

Kryesuesi – e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Shqipe Rama – sipas analizës që kam bë për raportin financiar, është bë një keqmenaxhim i theksum, sepse ka ni buxhet prej 1.119.000 euro. 319.925 janë mjete që nuk mund të shfrytëzohen, ndërsa pjesa e mjeteve vetanake për vitin 2019 – 2020 kap vlerën 774.915 euro, shumë e cila është tepër e lartë krahas nevojave që jemi në një gjendje pandemie. Sipas informacionit prej mbas lufte ky suficit është më i larti ndonjëherë.

Elmaze Bytyqi – te të hyrat vetanake dhe buxhetore, keni parapa një rritje nga qertifikatat rreth 30 %, realizimi është mjaft i vogël në krahasim me vitin 2020. Pjesa qesharake është participimi i shkollës së mesme “Skënder Luarasi”. Ku jeni bazu n’këtë planifikim? Shpenzimet e mjeteve vetanake i keni 73%, që tregon dështim në realizimin e projekteve. Kërkoj nga ju Kryetar të bëni planifikime më të sakta dhe më serioze.

Agim Bylykbashi – përshëndet të pranishmit. Te participimi te shkolla “Skënder Luarasi”, janë parapa mësim jasht orarit mësimor, të cilat paguhen, e që për shkak pandemie nuk janë mbajtur. Te qertifikatat e lindjes ne bëjmë një projekcion në bazë të kërkesave që na vin nga qarkorja buxhetore.

Kryesuesi – e hedh në votim

13 për, 1 kundër, 5 apstenime Miratohet

Pika 7.

Kryesuesi - e hedh në votim projekt-vendimin për anëtarin e re të KPF-së.

Unanimisht Miratohet

Pika 8. Projekt-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafostacioneve dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe e hap debatin.

Bashkim Ndrecaj - çmimi është 0.05 cent në meter katror .

Avni Bytyqi - kryetari ka propozuar kështu si jem duke e dhënë aktualisht pronën publike por prap është qështje e juaj.

Bashkim Ndrecaj - kundrejt çmimit të energjisë elektrike kjo është pak.

Shefket Kolgeci – në Komunitat tjera, a është ky çmim?

Kryetari - keni të drejt. Sa të doni vendosni për çmim, mirëpo është mirë me marrë investime nga këta për fshatra.

Bashkim Ndrecaj – ky po i kërkon 9 metër katror për trafo.

Kryetari – kontrata e re është Nishori,Breshanci,Kastërrci,Budakova ku do të kryhet komplet rrjeti.

Nexhat Ramadani - është dasht me bo ni analizë,që në një formë Komuna me pas disa të hyra aq sa janë reale,pa e pengu investimin.Çka bëhet me ato prona që janë dhënë pa kompenzim?

Jeton Rrakaqi – në mandatin e kalum ne si grup parlamentar kemi kërku këto që the ti Nexhat. Për ndryshe mos të ipen pronat pa kompenzim sepse KEDS-i është privat.

Nexhat Ramadani - unë të kuptoj,nuk e mohoj atë që kemi thënë atëherë.Atëherë rrethanat kanë qenë ndryshe dhe ne jemi detyru me dhan pa kompenzim.

Avni Bytyqi - jep sqarime si zyrtar ligjor lidhur me këtë pike.

Nexhat Ramadani - Nuk them që ta qesim një çmim të papërballueshëm

Jeton Rrakaqi - a ki naj informacion kur kanë bo apo a e ke par kontrata me Qeverinë e Kosovës dhe KEDS.

Avni Bytyqi - jo.

Xhemajl Kabashi -.A ka mundësi me ja kushtëzu këtyre që pas trafos mu bo rrjeti shpërndarës.KEDS-i kurrëfarë shërbime nuk ka.

Bashkim Ndrecaj – a kemi naj mekanizëm që nëse ai nuk i kryen investimet,me kushtëzu mi bo investimet.

Kryetari – ata na kanë tregu se ku do të investojnë dhe unë po ju tregoj,por nuk garantoj sepse ja ka dhënë ligji.

Kryesuesi – e hedh në votim me 0.10 cent për metër katror.

Unanimisht Miratohet

Pika 9. Diskutim lidhur me menaxhimin e investimeve kapitale;

Kryesuesi - kjo pikë është kërkesë e grupit paralamantar të LDK-së.

Nexhat Ramadani - sa i përket investimeve kapitale dhe menaxhimit këtë qeveri e karakterizojnë disa dukuri:e para është deformimi i listës së projekteve të miratuara nga ana e asamblesë,e dyta është paramasa pa projekte,joprofesionale,që e dëmtojnë buxhetin e Komunës dhe e treta është kualiteti i punimeve.Nuk them që s'janë bo edhe punë të mira.Rruga te tregu,është bë riparimi por jo si duhet,ka edhe rrugë të tjera.Gjatë analizës 95% e projekteve realizohen me nga ni paramasë,shumica janë të ngjajshme.Brigada 123 ka qenë 360 000 euro.Ju Kryetar pa vendim të Asamblesë keni vendos mi destinu diku tjetër me disa arsye,keni vazhdu,keni bë rrugë në qytet.Në vitin 2018-2019 në Mushtisht rruga “Ali Bytyqi”,edhe aty keni bo ndryshim pa naj vendim të Asamblesë,dhe prap në 2020 e keni fut në planifikim dhe prap skeni punu.Pastaj rruga në Studenqan,edhe këtu keni bo ndryshim pa vendim të Asamblesë.Rruga në Gelancë në vitin 2019 ka qenë projekti i miratum me këtë emër:rregullimi i rrugëve “Ramadan Bajrami”, “Kadri Halimi”.Në kontratën e parë mbesin disa rrugë që sjanë rregullu ,dhe në kontratën e dytë futni rrugë krejtësisht private,që ne kemi fakte.

Në vitin 2020,kontarta në Samadraxhë,buxheti i planifikuar 100 000 euro.Projekti i planifikuar,nërtimi i rrugëve lokale”Rgip Mamaj”,”Halil Bugari”,”Kalabrija”,”Xhemajl Halimi” në Samadraxhë.Në paramasë i shtoni edhe 9 rrugë tjera jasht Asamblesë.Për vitin 2020 në Sallagrazhdë buxheti planifikuar:34 000 euro.Emri i projektit:Ndërtimi i rrugës:”Sokol Tunaj”,”Freskia”,”Osman Limani” në Salagrazhdë,ku edhe këtu janë vendosur rrugë jasht planifikimit.

Ai gjithëashtu përmend edhe emrat e projekteve të planifikuara për vitin 2020 ,si në Grejkoc,Vraniq,Gelancë,Gjinoc,Leshan,Tërrnje,Buzhalë,Mushtish,Reqan,ku janë fut rrugë të paplinifikuara dhe pa vendim të Asamblesë,ai të gjitha këto projekte i tregon edhe permes skicave.

Kryetari – me anashkalu,me nënqmu nuk ka ndodh asnjëherë.Thoni që kam ndryshu projektet,por e dini shumë mire që ato para janë shpenzu po në të njejtin vend.Mund të them që mjetet që kanë qenë në Suharekë,nuk kanë dal jasht Suharekës.Mjetet që kanë qenë të një fshati nuk kanë shku në fshatra tjera.Në vitin 2015 nese ju kujtohet,ka qenë e parapame rruga në Shirokë por mjetet kanë ardh në Suharekë,dhe te ne nuk ka ndodh që mjetet e një fshati me shku në fshatin tjetër.Kryetari gjithëashtu arsyeton secilat projekte të secilit fshat që përmendi z.Nexhat Ramdani.Ai gjithëashtu thotë që për çdo dyshim janë organet tjera të rendit dhe mund ti paraqitni pa problem.

Nexhat Ramadani – unë jam mësuar me arsyetimet e Kryetarit.Me qenë deri 3 projekte ju kuptoj,por ktu s'ka arsyetim. Ka procedura pa kry,si arsyetohen këto?Mua më vje keq qe erdh puna te ky debat,por pikërisht pse kemi inicu është ndryshimi i vendimeve të Asamblesë,ku nuk përputhet as planifikimi,as ajo në procedure dhe as realizimi.

Kryetari - edhe këtë vit si ka fillu hapja dhe procedurat e prokurimit,si janë tu i marrë kompanitë,të njejtin rast ki me pas edhe këtë vit.Unë nuk muj me ndryshu.

Nexhat Ramadani – mu më intereson të di pse ke qit rrugë jasht planifikimit.

Jeton Rraçaqi – Unë e mirëpres këtë iniciativë të Nexhatit. Te Ligji i prokurimit publik,e vërtetë që ju nuk mundeni me përcaktu kujt me ja dhan punën,po ato punime a i mbikqyr dikush?

Punimet janë duke u kry në mënyrën ma të keqe të mundshme.Ligji nuk e lejon pranimin teknik të një pune me cilësi të dobët.

Kryetari – ne e kemi ndëshku ni kompani,ja kemi marrë punën me gjykatë,mirëpo ajo kompani me ankesë e merr punën për kanalizimin në fshatin Muhlan.

Bashkim Ndrecaj – arsyetimet e së kaluarës nuk të largojnë prej përgjegjësisë.Ju keni ardh si ndryshim.Nëse vendimet e Asamblesë i keni tjetërsu,ju e keni thy ligjin.

Kryetari – unë nuk kam nevojë me shku në hetuesi për zonë industriale,as për ndriçim dhe për shumë punë tjera,dhe s'do të shkoj.

Xhemajl Kabashi – qështja dhe arsyetimi është se po anashkalohet Asamblea.Ku është roli i Asamblesë këtu? Për hulumtime,keqpërdorime,pranime teknike janë prokuroria.

Leonard Shala – E përgëzoj Nexhatin për punën,por materiali e keni prur sot dhe s'kemi mujt me analizu,dhe nuk e di a ka të drejtë Nexhati.Nga ky diskutim duhet me dal me ni sugjerim që në të ardhmen secili investim të fillohet me një projekt.Kërkoj nga drejtori i shërbimeve publike që mbledhjen tjetër me na bind ne, që Nexhati e ka gabim.

Alban Berisha – Kryetar,e përmende që për çdo kritik dikush ka me dhan përgjegjësi.Prokuroria ka të drejtë mi nis hetimet kur sheh ndonjë parregullsi.Por ju si Kryetar Komune nuk do të thotë patjetër me qenë mbrojtës i administrates.Përgjigja juaj është,ja ku janë organet ,shkoni në prokurori.Por askush dej tash nuk dha përgjegjësi.Dua një përgjigje konkrete.

Kryetari – Nuk e kam në plan me mbrojt dikënd.Në tendecën e fundit e paraqitet problemën e gropave,dhe i mbulum me kubëza.Pra ju e dini që nuk mujm me asfaltu në muajin shkurt apo mars.

Nexhat Ramadani – ne e kemi obligim mu marrë me këtë qështje.Nëse jeni për diskutim dhe për me dhënë kontribut në përmirësimin e këtyre,nëse jo,propozoj që ne si Asamble ta miratojmë këtë deklaratë me anë të së cilës Asamblea Komunale konstaton: 1.Kryetari i Komunës dhe Qeveria Komunale ka bërë shkelje të ligjit duke mos zbatuar listen e investimeve kapitale ashtu si është miratuar nga Asamblea. 2.Planifikimi i investimeve kapitale është bo pa ndonjë analizë të mirëfillt dhe në mënyrë joprofesionale,pjesa dërmuese e projekteve realizohen pa projekt detal apo ideor por vetëm me paramasa.3.Realizimin e investimeve kapitale e përcjell kualiteti dhe mbykqyrja e dobët e punimeve.

Reshat Selimaj – kur e keni kalu buxhetin, ju e keni votu pa kushte por me hek edhe rrugë tjera. Kur janë planifiku rrugët, unë jam marrë me to, dhe e kemi fut me paramasën sipas inxhinierave 13 euro. Rrugën U Zeneli e kemi hek sepse s'ka pas infrastrukturë kanalizimi dhe e kemi qit këtë vit. Gjendja në Grejkoc është 95 % sipas planifikimeve. Dhe sa i përket punimeve edhe ju keni rregullu truarin te rruga Sabit Lushi pa planifikim.

Nexhat Ramadani – nuk tham që jemi përfekt.

Ardian Kotorri – është dasht që materiali të dërgohet me kohë. Si ta besoj pa e bërë një kontroll. Buxheti u miratu me këto rrugë në fshatin Samadraxhë, trego Nexhat, çka mi bo 50.000 euro, nëse mbesin 30 projekte nga 50.000 euro. Ai i arsyeton edhe disa projekte të tjera.

Nexhat Ramadani – unë e pranoj të mbetet në rrugë ose dy. Kush e ka të drejtën mi shtru këto rrugë.

Ardian Kotorri – forma e diskutimit la të kuptohet keq, por realisht nuk shoh diçka serioze. Kush ka të drejtë si Asamble me miratu këtë deklaratë që kryetari ka bo shkelje të ligjit, kush e vërteton?

Leonard Shala – unë jam pro debateve por nuk e mbështes deklaratën sepse është e tepër.

Alban Berisha – Nexhati tha që të ulemi dhe të bisedojmë nëse kemi me ndryshu diçka, por mos të bëhet praktike që për qështje të rëndësishme të lëshohet salla dhe mos me pas forum.

Kryesuesi - pasi nuk ka forum në sallë, e konstatoj të mbyllur takimin.

Takimi përfundoi: 13:50

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj